

AKT – THEMELIMI
I SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“Natural Herbal Essences” SHPK

Bazuar ne vullnetin e ortakut themelues dhe mbeshtetur ne Ligjin 9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, ndryshuar me Ligjin nr. 10 475, date 27.10.2011 vendoset si me poshte:

Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohezgjatja dhe Selia e Shoqerise.

Neni 1:

Themelimi, Themeluesit, Emri.

Sot me date 28/10/2021 themelohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar me emrin **“Natural Herbal Essences” SHPK**

Themeluesi i shoqerise **“Natural Herbal Essences” SHPK** , eshte ortaku i vetem **Marsida Musta**, atesia Asllan , lindur me 10.04.1984 , mbajtese e leternjoftimit me numer personal I45410125G, banuese ne Elbasan, madhore me zotesi te plote juridike e per te vepruar;

Neni 2:

Objekti i Shoqerise.

Objekti i veprimtarise i Shoqerise **“Natural Herbal Essences” SHPK** do te jete:

128 Kultivimi i erëzave, bimëve aromatike, farmaceutike dhe mjekësore
1101 Distilimi, rektifikimi dhe kombinimi i pijeve
1200 Prodhimi i produkteve të duhanit
2053 Përpunimi i vajrave esenciale
4675 Tregtia me shumicë e produkteve kimikë

Neni 3:

Kohezgjatja e shoqerise.

Kohezgjatja e shoqerise do te jete per nje periudhe te pacaktuar.

Neni 4:

Selia e shoqerise

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar **“Natural Herbal Essences” SHPK** ka seline e saj ne Elbasan , lagja “Visarion Xhuvani”, Elbasan , pallati 498/1, apartamenti 2, Elbasan. Shoqeria mund te kryeje e te transferoje, apo te suprimoje qendra administrative, seli, filiale, agjensi dhe zyra ne territorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte vendit.

Kreu II

Kapitali i shoqerise.

Neni 5:

Vlera dhe pagesa e kapitalit te paguar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100 000 (njeqind mije) leke. Pjesemarrja e themeluesit ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributin e tij si vijon :

Lloji i kontributit eshte ne para ne 100 000 (njeqind mije) leke, i ndare ne 1 kuote ne vleren 100 000 (njeqind mije) leke, e cila perben 100% vleren e kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar i shoqerise eshte shlyer dhe nenshkruar teresisht nga ortaku i shoqerise.

Kreu III

Administratori i shoqerise.

Neni 6:

Emerimi dhe kohezgjatja e Administratorit.

Asambleja e pergjithshme zgjedh nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise per nje periudhe pese vjecare (5vjet), ne pajtim me parashikimet e Ligjit 9901 date 14.04.2008, i ndryshuar. Emertimet do te jene individuale dhe sipas nje vendimi te marre me shumice te zakonshme nga Asambleja e Pergjithshme.

Administratori i pare i shoqerise per nje periudhe 5 (vjet) vjecare do te jete, **Z. Besnik Daci,** **atesia Sabri, mbajtes i leternjoftimit me numer personal I11008120P, banuen ne Elbasan,** **madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar.**

Kreu IV

Dispozitat Perfundimtare.



Neni 7:

Marredheniet e punesimit ne shoqeri do te rregullohen nepermjet kontrates se punesimit qe lidhet midis paleve ne mbeshtetje te Kodit te Punes si dhe akteve nenligjore te dala ne zbatim te tij.

Ortaku /ortaket e shoqerise nuk kufizohen ne rritjen e kapitalit te Shoqerise.

Mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate ushtrimit te veprimtarise private, midis ortakeve, punonjesve dhe personave te trete, kur ato nuk mund te zgjidhen me mirekuptim, mbetet ne kompetence te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Elbasan.

Shoqeria do te kete vulen e saj ku jane percaktuar dhe inicialet e emertimit tragtar.

Modalitet per ndryshimin dhe kompetencat e administratorit, kompetencat dhe marrja e vendimeve te Asamblese se Pergjithshme, zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit themeltar, etj, do te rregullohen nga Statuti i Shoqerise dhe Ligji 9901 14.04.2008 "2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", i ndryshuar si dhe Ligji 9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", i ndryshuar.

Ky akt themelimi eshte perpiluar ne kater kopje me vlere te njejete me originalin.

Elbasan, me date 28/10/2021

THEMELUES:
Zj. Marsida Musta

